



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



**KUVENDI I KOMUNËS  
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA  
01. NR. 06 - 4696/17  
KLINË, 11.8.2017**

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT  
I SEANCËS SË VIII-të TË KPF-së, MBAJTUR MË 11.8.2017, NË ORËN 10.00,  
NË SALLËN E KK**

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KPF-së, Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, OJQ “Koha”, etj.

Seancën e udhëhoqi, kryesuesi I KPF-së, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të KPF-së.

“Materialin bashkë me rendin e ditës e keni marrë me kohë. Hapi debatin rreth rendit të ditës”, tha Kryesuesi.

Nuk pati debate rreth rendit të propozuar të ditës.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës.

**Me vota unanime u miratua ky**

**REND I DITËS**

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi paraprak i buxhetit dhe të projekteve të Komunës për vitin 2018,
3. Shqyrtimi i propozimit për vendosjen e panos të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në sallën e KK,

#### **4. Të ndryshme.**

**Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi se në seancë mungan Pal Berisha.

**Pika e dytë: Shqyrtimi paraprak i buxhetit dhe të projekteve të Komunës për vitin 2018.**

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Hapi debatin rreth shqyrtimit paraprak të buxhetit dhe të projekteve të Komunës për vitin 2018.

Nuk patri debate.

Kryesuesi vuri [në](#) miratim rekomandimin për seancën e radhës në KK.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi i propozimit për vendosjen e panos të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në sallën e KK.**

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në shqyrtim, përkatësisht rreth vendosjes së një pano me anëtarë të Kuvendit, që nga legjislatura e parë e pasluftës. Kryesuesi sqaroi edhe formën se si do të dukej ajo pano me prezantimin e gjithë kryesuesve dhe anëtarëve të KK që nga legjislatura e parë e deri te kjo e fundit.

**Ndue Shabanaj**, foli rreth çështjes tematike. Profesor Shabanaj tha se le të shkojë cdo legjislaturë me emra dhe mbiemra të kryesuesve dhe anëtarëve të KK.

**Ramush Agushi**, tha se e përkrahi , edhe e fuqizoj këtë ide. “Është mirë që të duhet se kush ka qenë anëtarë i KK në legjislaturat e deritanishme të KK-së. Emrat e kryesuesve, përkatësisht fotografitë e kryesuesve le të figurojnë”, shtoi anëtari Agushi.

**Fadil Gashi**, foli rreth çështjes tematike. “Nuk është e nevojshme që të sigurohen fotografitë. Le të jetë unike”, shtoi anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Sigurimi i fotografive të të gjithë anëtarëve nga legjislatura e parë është tepër e vështirë për t'u siguruar, le të shkojë me sigurimin e emrave dhe mbiemrave, ndërkaoq në legjislaturën e ardhshme të shikojmë për sigurimin e fotografive”, shtoi kryesuesi.

**Hali Desku**, tha se duhet të marrim vendim që në legjislaturën e ardhshme të sigurohen edhe fotografitë. “Pra, në legjislaturën e ardhshme në pano të figurojnë fotografitë e anëtarëve, pasi që mund të sigurohen shumë lehta”, pohoi profesor Desku.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin.

**Me vota unanime u rekomandua propozimi për seancën e radhës të KK-së.**

**Të ndryshme.**

Kryesuesi theksoi se kam menduar që KK të ndajë mirënjojje për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës.


**Fadil Gashi**, theksoi se nuk do të tingëllojë mirë që për vete të ndajmë mirënjojje.

Kryesuesi falënderoi të pranishmit për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 10:30 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI



Kryesuesi i KPF-së  
Dr. Haxhi IBISHI

